



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 20, Datë 20.01.2025**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË  
SHOQËRISË “GREEN PLUS ENERGY” SH.P.K. PËR LICENCIM NË  
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.01.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 190 prot., datë 17.01.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “GREEN PLUS ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “GREEN PLUS ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2658 prot., datë 31.12.2024, ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacion në format elektronik për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3358, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a” dhe “c”; dhe për pikën 2.1 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Rezulton se shoqëria “GREEN PLUS ENERGY” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Kontratën nr. 2429 rep., nr. 1574 kol., datë 28.04.2023 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 MW, dhe veprave ndihmëse, në Zonën Kadastrale 3358, Njësia Administrative topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier”;
  - Ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së “Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a. nr. 5596/3 prot., datë 06.09.2024;
  - Ka depozituar Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më datë 17.07.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i impiantit PV”, nga shoqëria “Green Plus Energy” sh.p.k., me fuqi të instaluar 2 MW. Shoqëria ka bërë me dije se është në pritje të zbardhjes së lejes së ndërtimit dhe se po ndërmerr të gjitha veprimet e duhura për respektimin e procedurave të fillimit të punimeve. Ajo disponon një VNM të vlefshme deri më datë 17.07.2026, për këtë arsye duhet të fillojë punimet brenda këtij afati, në të kundërt do të duhet të depozitohet në ERE një VNM të re.
- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe informacioni/dokumentacioni në vijim:

## **NENI 9**

### **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**

#### **Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë**

##### *Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*

- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të plotësojë strukturën organizative (organigramën) e saj dhe me stafin tjetër që do t’i shërbejë veprimtarisë në të ardhmen.

##### *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitohet në ERE njoftimin e dërguar MIE-s për ndryshimin e vlerës së investimit.

- Shoqëria duhet të depozitohet një dokument teknik (garancinë përkatëse) për panelet fotovoltaike në lidhje me jetëgjatësinë e tyre nga ku do të llogaritet dhe afati i vlefshmërisë së licencës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GREEN PLUS ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3358, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “GREEN PLUS ENERGY” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**